DEKRET
Nr. 9405, datë 22.1.2016

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Albulena Lulzim Zyba
2. Miodrag Vido Zlatičanin (Tatiçaj)
3. Panajoti (Panagiotis) Edmond Koça (Kotsas)
4. Bujar Mahmut Bulica
5. Leonida Bujar Bulica
6. Buena Bujar Bulica
7. Enkeleda Selman Bulica (Kastrati)
8. Stela Prosper Martini
9. Ana Kujtim Hoxha
10. Cäcilia (Cacilia) Pellumb Shahini
11. Gëzim Dervish Haka
12. Irges Gezim Haka
13. Romeo Anesti Shuka
14. Jonida Ahmet Kulla
15. Denisa Ismet Marten (Lami)
16. Ilirjana Asllan Bajri (Muhametaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 36, datë 20.1.2016

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 10480, datë 17.11.2011, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRIJIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

1. Krijohet Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, në vijim "ISHMT", si institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë (në vijim ministri) dhe me seli në Tiranë.

II. MISIONI DHE FUNKSIONET E ISHMT-së

2. ISHMT-ja ka për mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi. ISHMT-ja është, gjithashtu, përgjegjëse për të monitoruar respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale, objekt inspektimi sipas këtij vendimi.

3. ISHMT-ja është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut të produkteve të destinuara për konsumatorët, sipas legjislacionit për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore dhe legjislacionit për tregtimin e mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, për të gjitha produktet, shërbimet apo grup-produktet joushqimore, si dhe për inspektimin e veprimtarive turistike, sipas legjislacionit për turizmin.

4. ISHMT-ja është, gjithashtu, përgjegjëse për inspektimin e zbatimit të kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e:

a) mbrojtjes së konsumatorëve, sipas përçaktimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;

b) mbrojtjes së pronësisë industriale, sipas përcaktimit të legjislacionit për pronësinë industriale;

c) garantimit të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas përcaktimit të legjislacionit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to;

ç) inspektimit metrologjik, sipas legjislacionit për metrologjinë;

d) etiketimit për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, sipas përcaktimit të legjislacionit për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji;

dh) kontrollin e detergjenteve të vendosura në treg sipas dispozitave të ligjit për detergjentet;

e) inspektimin e veprimtarive turistike, sipas dispozitave të ligjit për turizmin.

5. ISHMT-ja ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacionin e posaçëm të zbatueshëm në secilën nga fushat e inspektimit, të përmendura në pikën 4 të këtij vendimi, si dhe çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ISHMT-së

6. ISHMT-ja organizohet si drejtori e përgjithshme me juridiksion në të gjithë territorin e vendit.

7. Struktura dhe organika e ISHMT-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për tregtinë. Marrëdhëniet e nëpunësve të ISHMT-së rregullohen sipas ligjit të nëpunësit civil.

8. ISHMT-ja drejtohet nga kryeinspektori, i cili është titullari i institucionit, i emëruar sipas përcaktimeve të legjislacionit për nëpunësin civil, dhe ka këto përgjegjësi:

a) Planifikon, programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë në fushën e përgjegjësisë së ISHMT-së;

b) Siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e përgjegjësive të ISHMT-së;

c) Siguron unifikimin e praktikave të mbikëqyrjes të tregut dhe të inspektimit, në fushën përkatëse të përgjegjësisë;

ç) Siguron cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së ISHMT-së;

d) Informon publikun për veprimtarinë e ISHMT-së në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) Bashkëvepron dhe bashkërendon veprimtarinë e ISHMT-së me institucione të tjera shtetërore për fushën përkatëse të përgjegjësisë, si dhe me strukturën administrative përgjegjëse për politikat e mbikëqyrjes së tregut në ministrinë përgjegjëse për tregtinë;

e) Përfaqëson ISHMT-në në marrëdhënie me të tretët;

ë) Zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të ISHMT-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit;

f) I propozon për miratim ministrit rregulloren e brendshme të ISHMT-së dhe mbikëqyr zbatimin e saj;

g) Kryen çdo funksion tjetër si kryeinspektor apo titullar institucioni, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Në zbatimin e përgjegjësive të parashikuara në pikën 6 të këtij vendimi, kryeinspektori nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për veprimtarinë e strukturave të ISHMT-së në fushën e inspektimit që ai mbulon sipas legjislacionit në fuqi.

10. Përveç sa parashikohet në pikën 8, të këtij vendimi, kryeinspektori ka këto kompetenca direkte në lidhje me veprimtarinë konkrete të inspektimit:

a) Lëshon autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit;

b) Vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin;

c) Vendos për zëvendësimin e inspektorëve gjatë inspektimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin;

ç) Shqyrton ankimin e veçantë ndaj vendimeve për masat urgjente të marra nga inspektorët, sipas nenit 44, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

11. Pranë ISHMT-së krijohet Komisioni i Ankimit, që do të shërbejë për shqyrtimin e ankimeve administrative sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Komisioni i Ankimit ka në përbërje:

a) një përfaqësues të njësisë që mbulon çështjet juridike;

b) një përfaqësues që mbulon çështjet teknike dhe të metodologjisë së mbikëqyrjes së tregut dhe inspektimit;

c) dy nëpunës të tjerë të ISHMT-së të papërfshirë në veprimtari të drejtpërdrejta të inspektimit;

ç) një specialist i fushës nga ministria që mbulon çështjet, objekt inspektimi.

12. Lista emërore e Komisionit të Ankimit miratohet me urdhër të kryeinspektorit dhe bëhet publike në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në portalin "e-Inspektimi".

13. Komisioni i Ankimit funksionin në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.

IV. RAPORTIMI DHE MARRËDHËNIET ME MINISTRINË PËRGJEGJËSE

14. Kryeinspektori i ISHMT-së i raporton drejtpërdrejt ministrit dhe bashkërendon punën me strukturën administrative të referuar në shkronjën "dh", të pikës 8, të këtij vendimi, siç parashikohet në legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore dhe legjislacionin për tregtimin e mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore.

15. Ministri apo struktura administrative sipas shkronjës "dh", të pikës 8, të këtij vendimi, ka të drejtë të kërkojë raporte, informacione, dokumente për menaxhimin institucional dhe financiar të inspektoratit dhe veprimtarinë e inspektimit në përgjegjësi apo për çështje konkrete. Informacioni apo dokumentet paraqiten brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

16. ISHMT-ja përgatit dhe i propozon për miratim ministrit:

a) programin vjetor të inspektimit për vitin pasardhës;

b) objektivat vjetorë dhe afatmesëm strategjikë të ISHMT-së për vitin pasardhës;

c) treguesit vjetorë specifikë të efektivitetit të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe punës së ISHMT-së për vitin pasardhës.

17. Programi vjetor i inspektimit, parashikuar në shkronjën "a", të pikës 14, të këtij vendimi, i paraqitet ministrit për miratim, brenda datës 15 dhjetor të vitit paraardhës, pas marrjes së mendimit këshillimor të Inspektoratit Qendror sipas legjislacionit në fuqi.

18. Objektivat vjetorë dhe afatmesëm strategjikë të ISHMT-së dhe treguesit vjetorë specifikë të efektivitetit të cilësisë të veprimtarisë të inspektimit dhe punës të ISHMT-së paraqiten për miratim, brenda afatit të parashikuar në pikën 15, të këtij vendimi.

19. ISHMT-ja harton dhe miraton, gjithashtu, raportin vjetor të inspektimit, i cili i paraqitet ministrit përgjegjës për tregtinë dhe Inspektoratit Qendror brenda datës 15 shkurt të vitit pasardhës së bashku me raportin e realizimit të objektivave vjetorë dhe treguesit vjetorë të efektivitetit e të cilësisë së inspektimit.

20. Ministri përgjegjës për tregtinë, bazuar në raportin vjetor të inspektimit e raportin për objektivat vjetorë dhe treguesit vjetorë, përgatit një raport vlerësimi për punën e ISHMT-së dhe të kryeinspektorit. Raporti bëhet publik me mjete të përshtatshme.

V. STEMA DHE VULA ZYRTARE E ISHMT-së

21. ISHMT-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

22. Stema e ISHMT-së përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: "Republika e Shqipërisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut".

23. Vula e ISHMT-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare" dhe shënimin identifikues "Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut".

VI. DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

24. Nëpunësit civilë, që kryejnë funksionet e inspektimit metrologjik e që janë aktualisht pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, transferohen me përparësi në ISHMT, në zbatim dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil.

25. Punonjësit, që kryejnë funksionet e inspektimit të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, transferohen në ISHMT.

26. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë rishikohet për shkak të kalimit të funksionit të inspektimit metrologjik në ISHMT.

27. Ngarkohet ministri, që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t'i propozojë Kryeministrit, nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike:

a) strukturën dhe organikën e ISHMT-së, sipas ligjit;

b) ndryshimet në strukturën dhe organikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1 janari 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 264, datë 11.1.2016

MBI BASHKËPUNIMIN E STRUKTURAVE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME, MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME DHE SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR PËR PROCEDURAT E LËSHIMIT TË VIZAVE PËR TË HUAJT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 25, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 513/2013, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", me qëllim harmonizimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për lëshimin e vizave, hyrjen, qëndrimin dhe tranzitimin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJMË:

I. INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË PROCEDURËN E LËSHIMIT TË VIZAVE

1. Autoritetet kompetente që bashkëpunojnë në procesin e lëshimit të vizave për hyrjen, qëndrimin dhe tranzitimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, janë:

a) Në Ministrinë e Punëve të Jashtme (më poshtë "MPJ") – Drejtoria e Çështjeve Konsullore (më poshtë "DÇK") dhe Përfaqësitë Diplomatike dhe Konsullore (më poshtë "PDK") të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit;

b) Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (më poshtë "MPB") – Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Policisë së Shtetit (më poshtë "DPKM");

c) Shërbimi Informativ i Shtetit (më poshtë "SHISH").

2. Brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, secili nga autoritetet e sipërpërmendura bashkëvepron me institucionet e tjera për çështjet e trajtimit të aplikimeve për viza, për hyrjen, qëndrimin dhe tranzitimin e të huajve, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

II. PROCEDURA E APLIKIMIT PËR VIZË NË PDK

1. PDK të RSH-së apo PDK të një shteti tjetër me të cilin qeveria e Republikës së Shqipërisë ka lidhur marrëveshje përfaqësimi për pranimin e aplikimeve për vizë, pranojnë kërkesat për pajisje me vizë të shtetasve të atij vendi apo rezidentë në atë vend, sipas listës në aneksin 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 13.6.2013, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë" apo të përfaqësuesve të shoqërive turistike shqiptare ose të shtetasve të tjerë të huaj sipas miratimit paraprak të DÇK-së në MPJ.

2. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesës për vizë, të paraqitur personalisht nga i huaji në PDK, kryhet nga nëpunësi konsullor, i autorizuar dhe i trajnuar për çështjet e vizave, si dhe i certifikuar për shqyrtimin e dokumentacionit të klasifikuar, i cili interviston të huajin për verifikimin e fakteve të paraqitura në kërkesë më poshtë "Konsulli".

3. Përjashtohen nga detyrimi për t'u paraqitur personalisht për të aplikuar për vizë në PDK të huajt që plotësojnë kriteret sipas kreut II, pika 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 13.6.2013 ose raste të miratuara me udhëzim të DÇK-së.

4. Aplikimi për vizë pranohet kur dokumentacioni i dorëzuar është në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 13.6.2013. Nëse gjykon të arsyeshme, konsulli kërkon dokumente shtesë apo kthen aplikimin për plotësim në rast dokumentacioni të paplotë. Arsyeja e kthimit mbahet shënim dhe i komunikohet me shkrim të huajit.

5. Ka përparësi pranimi i aplikimeve për vizë nga shoqëri turistike shqiptare në një nga PDK-ja në vendet fqinje ose nga vendet e tjera të ndryshme nga ato të origjinës.

6. Pas pranimit të aplikimeve për vizë, konsulli, brenda ditës, regjistron aplikimet në Regjistrin Elektronik për të Huajt REH (më poshtë moduli "E-Viza"), duke plotësuar të gjitha rubrikat, si dhe vlerësimin e tij paraprak dhe rekomandimin për prioritetin e trajtimit të aplikimit dhe miratimin ose refuzimin e vizës së kërkuar. Ai mban përgjegjësi për saktësinë e përcjelljes së të dhënave.